



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 147, datë 26.06.2020

PËR CAKTIM NË POZICION TË PËRKOHSHËM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. **Znj. Alma Bramo**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, caktohet përkohësisht si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.
2. Znj. Alma Bramo, do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, nga data **29.06.2020 - 28.09.2020**.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, Znj. Bramo do të paguhet me pagën e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.
4. Të njoftohen me këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Znj. Alma Bramo, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GËNT IBRAHIMI

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

